

**KONTRATË DHURIMI TË KUOTAVE TË KAPITALIT
THEMELTAR TË SHOQËRISË " HIDROIZOLIME EDA " SH.P.K**

Sot më datë 15.09.2023 në selinë e shoqërisë " HIDROIZOLIME EDA " shpk me adresë "Durrës Ishem DRAC Gjiri Lalezit – Drac" u paraqitën personalisht palët kontraktuese me cilësitë e mëposhtme dhe nënshkruan këtë kontratë:

PALA DHURUESE

Z. Artan QERIQI i datelindjes 05/04/1990, lindur ne Connecticut USA, banues ne Shtetet e Bashkuara te Amerikes madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar me dokument identifikues pasaporte Nr.578282891.

DHE

PALA PRANUESE E DHURIMIT

Z. Dardan ZOGJANI i datelindjes 05/04/1982, lindur ne Prishtine dhe banues ne Kosove , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar me dokument identifikues leternjoftim Nr. personal 1001064017.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.9901, date 14.04.2008 Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare
Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

NENI 1


KUSHTET E KONTRATËS

Në lidhjen e kësaj Kontrate ekziston pëlqimi i palëve në marrjen përsipër të detyrimeve përkatëse, shkak i ligjshëm në të cilin mbështeten detyrimet, dhe objekti që formon lëndën e kontratës.

Kontrata quhet e vlefshme meqënëse palët kanë shfaqur dhe shprehur në mënyrë të ndërsjelltë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj.

Në këtë Kontratë, palët shprehin dhe garantojnë që shkak i ligjor i lidhjes së saj nuk është i paligjshëm, nuk vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik si dhe Kontrata nuk shërben si mjet për të shmangur zbatimin e një norme të legjislationit shqiptar.

ARTAN QERIQI


Dardan Zogjani


KUSHTE PARAPRAKE

Rezulton se Shoqëria "HIDROIZOLIME EDA" shpk regjistruar në QKB në datë 25/07/2023 me seli në Durres Durres Ishem DRAC Gjiri Lalezit – Drac me Nr NIPT M31925009L është person juridik shqiptar me kapital themeltar 100.000,00 dhe numër të përgjithshëm kuotash 3,00.

Shoqëria ka si objekt veprimtarie : " Tregtim te gjitha materialeve ndertimore. Marrje persiper e punimeve te gjithave materialeve ndertimore, .Shitje me shumice dhe me pakice te materialeve qe shoqeria tregon. Blerje dhe shitje te pronave te paluajtshme dhe pronave te luajtshme. Shoqeria mund te kryeje te gjitha aktivitetet e dobishme dhe/ose te nevojshme te lejuara nga legjislacioni ne fuqi, per realizimin e objektit te veprimtarise se shoqerise

Ortakët e shoqërisë janë:

1. Z. Endrit Breçani zotëron 1 pjesë të kapitalit të shoqërisë "HIDROIZOLIME EDA" shpk me vlerë 50,000.00 dhe pjesëmarrje në përqindje 50%.
2. Z. Artan Qeriqi zotëron 1 pjesë të kapitalit të shoqërisë "HIDROIZOLIME EDA" shpk me vlerë 25,000.00 dhe pjesëmarrje në përqindje 25%.
3. Z. Dardan Zogjani zotëron 1 pjesë të kapitalit të shoqërisë "HIDROIZOLIME EDA" shpk me vlerë 25,000.00 dhe pjesëmarrje në përqindje 25%.

Në datë 15.09.2023 ortaku i shoqërisë "HIDROIZOLIME EDA" shpk Z. Artan Qeriqi ka vendosur dhurimin plotësisht të kuotave të kapitalit themeltar që disponon në shoqëri palës pranuese të dhurimit Z. Dardan Zogjani.

NENI 2

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj Kontrate është dhurimi pa kundërshtëpërblim i kuotave të kapitalit themeltar që dhuruesi disponon në shoqërinë " HIDROIZOLIME EDA " SH.P.K dhe pranimi i dhurimit të kuotave të kapitalit nga pala pranuese e dhurimit si më poshtë vijon:

Objekti i kësaj kontrate është transferimi i kuotave nëpërmjet kontratës së dhurimit të:

- Ortaku i shoqërisë " HIDROIZOLIME EDA" shpk, Z. Artan Qeriqi dhuron 25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë palës pranuese të dhurimit Z. Dardan Zogjani.

Dhuruesi ka të drejta të plotë dhe ekskluzive të pronësisë dhe posedimit të kuotave të kapitalit të shoqërisë tregtare " HIDROIZOLIME EDA " SH.P.K

ARTAN QERIQI
A. Qeriqi

Dardan Zogjani
D. Zogjani

NENI 3

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E DHURUESIT

Në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate dhurimi, dhuruesi heq dorë përfundimisht nga pronësia e tij në masën 25% të kapitalit themeltar të pjesës takuese që zotëron pala dhuruese.

Në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate dhuruesi zhvishet nga pronësia e tij konkretisht 25% të pjesës takuese që zotëron.

Dhuruesi garanton pranuesin e dhurimit se kuotat e kapitalit themeltar që ai zotëron në pjesët takuese në shoqërinë " HIDROIZOLIME EDA " shpk janë lirisht të transferueshme sipas ligjit.

Dhuruesi garanton pranuesin e dhurimit nga cdo pretendim i palëve të treta lidhur me pronësinë e kuotave të kapitalit objekt i kësaj kontrate dhurimi.

NENI 4

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PRANUESIT TË DHURIMIT

Në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate pranuesi i dhurimit pranon pronësinë në pjesët takuese 25% të kapitalit themeltar.

Në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate pranuesi i dhurimit bëhet pronarë të 25% të kuotave të kapitalit palë pranuese Z. Dardan Zogjani.


Për cdo pretendim që mund të lindë nga palët e treta referuar objektit të kësaj kontrate , pala pranuese e dhurimit duhet të njoftojnë menjëherë palën dhuruese.


NENI 5

PËRBËRJA E SHOQËRISË

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit struktura e kapitalit të shoqërisë do të jetë sipas tabelës si më poshtë vijon :

ORTAKËT	% NË KAPITALIN E SHOQËRISË
Endrit Breçani	50 %
DardanZogjani	50 %

ARTAN QERIQI


Dardan Zogjani


NENI 6

EFEKTET E KONTRATËS

Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Kjo kontratë ka forcën e ligjit për palët kontraktuese.

Kontrata ka efekt ndaj të tretëve dhe subjekteve të tjera sipas parashikimeve të ligjit.

NENI 7

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Palët angazhohen të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit ndërmjet tyre, problemet do të mundohen të vlerësohen me anë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Në rast të konflikteve gjyqësore, Gjykata kompetente do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 8

TË NDRYSHME


Ngarkohen palët ose persona të autorizuar prej tyre që të kryejë rregjistrimin e kësaj kontrate në QKB me efekt të ligjshëm nga data e kontratës.


Palët deklarojnë që janë dakort me përmbajtjen e bërë në këtë kontratë dhe se ortakëria e shoqërisë tregtare në vijim do të jetë sipas nenit 5 të kësaj kontrate.

Kontrata redaktohet në 3 ekzemplarë autentik në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë juridike. Secila palë mban nga një ekzemplarë, ndërsa një ekzemplarë depozitohet në QKB sipas ligjit.

Palët deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim për sa më sipër dhe se kanë disponuar me vullnet të lirë, të plotë dhe të pavesuar.

Kontratës i bashkangjiten kopje të letërnjoftimeve të palës dhuruese dhe palës pranuese të dhurimit dhe kopje e ekstraktit të Shoqërisë.

ARTAN QERIQI



Dardan Zogjani


Përfundimisht palët kontraktore , pasi redaktuan bashkarisht këtë kontratë sipas vullnetit të lirë dhe të plotë e lexojnë bashkarisht kontratën dhe pasi e gjejnë në përputhje me qëllimin e tyre si dhe vullnetin e lirë kontraktor , e nënshkruajnë personalisht duke i dhënë fuqi ligjore;

PALËT KONTRAKTORE


PALA DHURUESE

ARTAN QERIQI



PALA PRANUESE TË DHURIMIT

Dardan Zogjani



HIDROIZOLIME EDA
Sh.p.k.
NIPT : M 31925009 L
TIRANE - ALBANIA